



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E VËZHguesve AFATSHKURTËR DHE PËRKTHYESIT TË
AMBASADËS GJERMANE NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 27.06.2019 me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Miratimi i vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesit të paraqitur nga Ambasada Gjermane për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor, 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"



Nr.891 i Vendimit Data 27 .06.2019 Ora 14 .⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesit të Ambasadës Gjermane për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor, 2019.

V Ë R E N

Ambasada Gjermane ka paraqitur kërkesën e saj me nr.Prot 12478 të datës 27.06.2019, bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyesi të tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se ai është brenda kushteve dhe kërkesave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4, 5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Gjermane për akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyesi për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor, 2019, sipas listës së përcaktuar në lidhjet Nr.02 dhe Nr.03, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund te bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr.891 i Vendimit Data 27 .06.2019 Ora 14 .⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesit të Ambasadës Gjermane për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor, 2019.